REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.86, datë 29.10.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI I SKRAPARIT", Z.FITIM NUELLARI

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29.10.2026, mori në shqyrtim projektaktin e mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 8,9 dhe 11 të ligjit nr.94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë", si dhe Vendimin nr.609, datë 15.10.2026 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

VENDOSI:

Ti jepet titulli "Qytetar Nderi i Skraparit", z.Fitim Nuellari, me motivacion:

"Në vlerësim të lartë dhe në shenjë mirënjohje për kontributin e tij publik si kryetar i parë i Bashkisë së Çorovodës në sistemin e ri pluralist. Individ që ka shërbyer dhe drejtuar me përkushtim, ndërgjegje dhe integritet të lartë në qeverisjen vendore, duke fituar kësisoj respektin dhe vlerësimin e veçantë të bashkëqytetarëve të tij".

Vendimi u miratua me 13 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SKRAPAR

Rruga: "Pasho Hysi" Lagjja: "Çlirimi" Çorovodë, Skrapar Telefon: +355 31222512email:bashkiacorovode@ymail.com